

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, si gjykatë e shkallës së parë, gjyqtari Naim Kurtishi, me bashkëpunëtorin profesional, Shahadin Destani, në kontestin e paditësit PTK i Kosovës - VALA, me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson S... Th... nga Prizreni, kundër të paditurës M... S... nga Prizreni rr. "..." nr., me objekt të padisë pagimi i borxhit, vlera e kontestit 2.464,42 € pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, në prezencën e të autorizuarit të palës paditëse e në mungesë së të palës së paditur, me dt.30.04.2015 morri këtë

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit PTK -VALA- Prishtinë dhe **OBLIGOHET** e paditura M... S... nga Prizreni që në emër të borxhit të ia paguajë paditësit shumën prej 2.464.42 €, dhe atë me kamat ligjore si përmjete të deponuara pa destinacion të caktuar nëpër Banka private të Republikës së Kosovës, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit 30.04.2015, deri në pagesën përfundimtarë si dhe shpenzimet procedurale në shumën prej 20 euro në emër të taksës gjyqësore, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën ekzekutim të përmbarimit ligjor.

II. Me shpenzimet e procedurës obligohet pala e paditur.

A r s y e t i m

I autorizuari i paditësit gjatë shqyrtimit kryesor ka ngelur në tërësi në të dhënët e padisë dhe të dhënët nga shqyrtimet e mbajtura, duke kërkuar që kërkesëpadia të aprovohet në tërësi dhe e paditura të obligohet që paditësit t'ia kompensojë borxhin në shumë prej 2.464,42 €. I autorizuari i paditësit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se me provat që janë administruar është argumentuar dhe është vërtetuar fakti se pala e paditur e ka shfrytëzuar telefonin roming që është me numër dhe i regjistruar në emër të saj dhe se përkundër faktit se ka pas mundësi të bëhet reklamacion apo vërejtje në lartësinë e faturave që i janë dedikuar të njëjtës e njëjta asnëherë nuk ka bërë kurrfarë ankesë në faturat dhe llogarinë e bërë për shfrytëzimin e këtij telefoni. Pra me që pala paditëse ka ofruar këtë shërbim në llogari të palës së paditur dhe e njëjta nuk ka kompensuar tanë shumën e arritur në lartësi prej 2464.42 Euro, e që të njëjtën shumë duhet ta kompensoj duke llogaritur dhe kamatën ligjore 3.5% nga data e parashtrimit të padis si dhe kompensimin e shpenzimeve të kësaj procedure.

E paditura M... S... nga Prizreni edhe pse nga gjykata është thirrur në mënyrë të rregullt i cili fakt është vërtetuar nga fletëdërgesa e cila gjendet në shkresat e lëndës e të cilën e paditura e ka pranuar dhe e ka nënshkruar me datën 27.03.2015, e njëjta nuk ka prezantuar në shqyrtimin kryesor si dhe mungesën nuk e ka arsyetur prandaj gjykata me aplikimin e dispozitave ligjore të parapara me nenin 423.3 të LPK-së, ka vendosur që shqyrtimin e datës 30.04.2015 ta mbaj në mungesë të palës së paditur.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat:

Është bërë shikimi dhe leximi i kontratës të nënshkruar nga palët kontraktuese paditësit dhe të paditurës, e datës 10.02.2009;

Është lexuar informata në formë të shkruar, e dedikuar për klienten M... S... nga Prizreni;

Është bërë leximi dhe shikimi në historinë e llogarisë për M... S... e datës 22.09.2010.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura në kuptim të nenit të Ligjit Për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha atë së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësit është e **bazuar**.

Me leximin kontratës, e datës 10.02.2009, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja PTK-Vala ka lidhur kontratë me të paditurën M... S... nga Prizreni, me të cilën e paditura M... S... ka shfrytëzuar shërbimet “vala extra dhe Instalation Free” e ofruara nga paditësi lidhur me shfrytëzimin e numrit telefonik mobil të valës M... S..., e cila kontratë është konstatuar se është lidhur me datë 10.02.2009 dhe është nënshkruar nga palët kontraktuese.

Në bazë të informatës së shkruar për klientin, si dhe Historisë së llogarisë të datës 22.09.2010 të lëshuara nga paditësja PTK-Vala, në emër të të paditurës M... S... gjykata ka vërtetuar faktin se borxhi në emër të të paditurës ka arritur vlerën në shumën prej 2,464.42 euro.

Prandaj gjykata pas analizimit dhe vlerësimit të provave të lartcekura ka vërtetuar se e paditura ka shfrytëzuar telefonin mobile të Vala dhe i ka borxh paditësit shumën prej 2,464.42 euro, për shfrytëzimin roming të telefonit mobil me numër ... i cili borxh është vërtetuar nga historia e llogarisë e datës 22.09.2010, nga informata për klientin si dhe nga kontrata e datës 10.02.2009, andaj gjendja ekzistuese reale tregon për ekzistimin e borxhit nga ana e të paditurit në emër të shfrytëzimit të telefonisë mobile - roming.

Baza ligjore

Me nenin 17 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) – i aplikueshëm Ligji Nr.04/L-077, është paraparë se “*pjesëmarrësit e detyrimit kanë për detyrë që ta zbatojnë detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përbushjen e tij*”, ndërsa me nenin 262 të po këtij ligji, është paraparë se “*kreditori në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përbushjen e detyrimit, ndërsa debitorit ka për detyrë të përbushë me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përbajtja e tij*”.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është konform nenit 452.1 të LPK-së.

Nga të lartcekurat dhe bazuar në nenin 17 dhe 262 të LMD-së, lidhur me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në diapositiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.11/14, datë 30.04.2015

Bashkëpunëtori profesional

Shahadin Destani



UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së të njëjtë, Gjykatës së Apelit Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.